



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KURBIN

KRYETARI

Nr. _____ prot.

Laç, më _____.____.2023

**FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT 2
(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)**

Data 09.06.2023

Drejtuar: Operatorit ekonomik “ARTEO 2018” SHPK, **Adresa:** Elbasan Elbasan Lagjja
Luigj Gurakuqi, Bulevardi Aqif Pasha, Hotel Skampa, kati 5 nr.303.

Procedura e prokurimit/lotit: “Procedurë e hapur e thjeshtuar” Mallra (Prokurim me mjete elektronike).

Numri i procedurës / referenca e Lotit: **REF-68417-05-05-2023**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Blerje Kontenierësh, Bashkia Kurbin”.

Fondi limit: **1,666,650** (një milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH.

Kohëzgjatja e kontratës: Brenda 10 ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës.

Publikimet e mëparshme (*nëse është rasti*): Buletini i Njoftimeve Publike Nr.36, datë 24.04.2023.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomkisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomkisht më e favorshme bazuar në çmim **X**

Me anë të kësaj ju informojmë se Ofertuesit e mëposhtëm kanë marrë pjesë në këtë procedurë me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “CompiTel” SHPK, me numër NIPTI M31417021V,
Vlera e ofertuar: 1,580,000 (një milion e pesëqind e tetëdhjetë mijë) lekë **pa TVSH.**
2. Operatori ekonomik “ARTEO 2018” SHPK, me numër NIPTI L82523203F

Vlera e ofertuar: 1,648,000 (një milion e gjashtëqind e dyzet e tetë) lekë **pa TVSH.**

3. Operatori ekonomik “**V.A.L.E. RECYCLING**” SHPK, me numër NIPTI **L28029301Q.**
Vlera e ofertuar: 1,650,000 (një milion e gjashtëqind e pesëdhjetë mijë) lekë **pa TVSH.**

Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

- I. Operatori ekonomik “**CompiTel**” SHPK, me numër NIPTI **M31417021V.**

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Në mbështetje të nenit 92, pika 3 të ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ku parashikohet se: **"Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit**, si dhe të nenit 82, pika 2, Kreu X, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se: **"Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme....."**, oferta refuzohet pasi nuk janë plotësuar pikat si më poshtë vijon:

1. OE nuk plotëson pikën 2.2.1 të DST, përkatësisht:

2.2.1. *Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për 3 (tre) vitet e fundit financiare (2021-2022), ku vlera e xhiros për të paktën njërin nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë **jo më e vogël se 40%** e vlerës së parashikuar të kontratës.*

KVO konstatoi se: OE “CompiTel” SHPK nuk ka paraqitur **Vërtetim për xhiron vjetore për 3 (tre) vitet e fundit financiare (2021-2022)**, kriter ky i përcaktuar dhe i kërkuar nga Autoriteti Kontraktor në DST.

2. OE nuk plotëson pikën 2.2.2 të DST, përkatësisht:

2.2.2 *Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare (2021, 2022) të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, pika "c", të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku bilancet e kerkuara nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitet dhe pasivitet.*

KVO konstatoi se: OE “CompiTel” SHPK nuk ka paraqitur **bilancet vjetore, për vitet financiare (2021, 2022)**, kriter ky i përcaktuar dhe i kërkuar nga Autoriteti Kontraktor në DST.

II. Operatori ekonomik “V.A.L.E. RECYCLING” SHPK, me numër NIPTI L28029301Q.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Në mbështetje të nenit 92, pika 3 të ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ku parashikohet se: **“Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit**, si dhe të nenit 82, pika 2, Kreu X, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se: **“Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.....”,** oferta refuzohet pasi nuk janë plotësuar pikat si më poshtë vijon:

1. OE nuk plotëson pikën 2.3.1 të DST, përkatësisht:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*

KVO konstatoi se: OE “V.A.L.E. RECYCLING” SHPK nuk ka paraqitur **dokumentacion për furnizimet e mëparshme të ngjashme**, kriter ky i është kërkuar nga Autoriteti Kontraktor në DST.

Sqarojmë se operatori ekonomik ka paraqitur një kontratë shërbim pastrimi me Bashkinë Lezhë, **por kjo kontratë nuk është bindëse**, pasi Autoriteti Kontraktor në DST ka kërkuar në pikën 2.3.1 germa ‘a’ se: *për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.* Theksojmë se operatori ekonomik “V.A.L.E. RECYCLING” SHPK, për këtë kontratë, nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion që vërteton përmbushjen me sukses të kontratës.

2. OE nuk plotëson pikën 2.5 të DST, përkatësisht:

2.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë edhe deklaratat si mëposhte:

- a) Operatori ekonomik duhet të deklarojë, se plotëson specifikimet teknike që Autoriteti Kontraktor ka kërkuar për kontenierët dhe nëse shpallet fitues do ti paraqesë mallrat sipas specifikimeve teknike që Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar.*
- b) Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë garancie të mallrave që kërkohen të prokurohen, nëpërmjet së cilës duhet të marrë përsipër dhe të garantojë: riparimin, mirëmbajtjen dhe shërbimin pa pagesë, të defekteve për shkak të prodhimit, për një periudhë 6 muaj nga koha e marrjes në dorëzim të mallrave nga Autoriteti Kontraktor.*
- c) Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit, në ambjentet e Bashkisë Kurbin nga nënshkrimi i kontrates sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor.*

KVO konstatoi se: OE “V.A.L.E. RECYCLING” SHPK nuk ka paraqitur **Deklaratat për plotësimin e pikës 2.5**, kriter ky i cili është kërkuar nga Autoriteti Kontraktor në DST.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik “**ARTEO 2018**” SHPK, me numër NIPTI **L82523203F**, me përfaqësues ligjor **z. Artan Topi**, me adresë: Elbasan Elbasan Lagjia Luigj Gurakuqi, Bulevardi Aqif Pasha, Hotel Skampa, kati 5 nr.303, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej: **1,648,000** (një milion e gjashtëqind e dyzet e tetë) lekë **pa TVSH**, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë Kurbin, adresa: Lagjia Nr.3, Laç (në zyrën e protokollit të Bashkisë Kurbin), sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se, nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar, tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet siguri i ofertës suaj dhe do të vepohet siç parashikohet në Ligjin nr.162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

JO (Nuk ka patur)

Titullari i Autoritetit Kontraktor
Majlinda CARA